



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 17, datë 10.05.2019

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË ZONJËS LEFTERI LLESHI (LUZI), PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/ Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare Dorina Dulaj,

Me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- zotit Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- zonjës Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 10.05.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDADI PËR INSPEKTOR
I LARTË I DREJTËSISË:**

Zonja Lefteri Lleshi (Luzi)

OBJEKTI:

Tërheqje nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, zonjës **Margarita Buhali**,

mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit,

dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 01.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 199 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është edhe zonja Lefteri Lleshi (Luzi).
4. Në zbatim të nenit 147/d dhe 149/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 dhe 235 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Margarita Buhali.

7. Zonja Lefteri Lleshi (Luzi), si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Kopje e njoftimit me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi), gjendet në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 08.04.2019, kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, kopje e së cilës gjendet në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 16.04.2019, kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) ka kthyer përgjigje në adresën e email-it me të cilën është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit (konkretisht info@ked.gov.al) me anë të së cilit, njofton Këshillin se ka vendosur të tërhiqet nga kandidimi për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Ky email gjendet në dosjen e kandidimit dhe një kopje i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Në zbatim të pikës 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, ka njoftuar Këshillin lidhur me vullnetin e shprehur nga kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) për tërheqjen nga kandidimi për këtë vend vakant, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim relacionin dhe projektaktin përkatës mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kësaj kandidate.

11. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 10.05.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.

12. I njëjti njoftim, së bashku me materialet e çështjes i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

13. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 10.05.2019 dhe rendin e ditës janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

14. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

15. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se; procedura e ndjekur nga ana e këshillit është në zbatim të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “ Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante të Gjykatës Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Gjithashtu, rezultoi se vullneti i kandidatit për tërheqje nga kandidimi është i qartë sipas aktit të dorëheqjes të paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

16. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga anëtari i Këshillit relator i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimin, pikëzimit dhe renditjes së kandidatës Lefteri Lleshi (Luzi).

17. Në pikën 1 të nenit 201 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” parashikohet se:

“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi”.

18. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 199 dhe 229 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, në përfundimit të afatit të caktuar të shpalljes “Për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant Inspektor i Lartë i Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi ka administruar dokumentacionin e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë pozicion, ka filluar në datën 05.04.2019 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

19. Ligji nr. 115/2016 nuk parashikon në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në raste të tilla.

20. Por, nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se :

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

21. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë aktin nënligjor normativ, vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*.

22. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në pikat 8 dhe 31 të tij, parashikohet se :

“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.”

“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.”

23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore normative të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatës Lefteri Lleshi (Luzi). Kandidatja është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, është paraqitur në datë 08.04.2019.

24. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton që kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi), në datën 16.04.2019, kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) ka kthyer përgjigje në adresën e email-it me të cilën është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit (konkretisht (info@ked.gov.al) me anë të së cilit, njofton Këshillin se ka vendosur të tërhiqet nga kandidimi për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Ky email gjendet në dosjen e kandidimit dhe një kopje i bashkëlidhet këtij vendimi.

25. Këshilli vlerëson të rregullt në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej kësaj kandidate për tërheqjen nga kandidimi, emailin e paraqitur për këtë qëllim nga kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi).

26. Këshilli vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen për Inspektor të Lartë të Drejtësisë është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

27. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikave 8 dhe 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Lefteri Lleshi (Luzi).
3. Kandidati Lefteri Lleshi (Luzi) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 17/1 , datë 05.06.2019

PËR KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE TË VENDIMIT NR. 17, DATË 10.05.2019 TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI “ PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË ZONJËS LEFTERI LLESHI (LUZI), PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË”

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e Avokates së Popullit, **zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,
Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:
- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,
në mbledhjen e datës 05.06.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDADE PËR INSPEKTOR
I LARTË I DREJTËSISË :**

Zonja LEFTERI LLESHI (LUZI)

OBJEKTI:

**Korrigjim i vendimit nr. 17, datë 10.05.2019 i
Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, zonjës Margarita Buhali, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Në datën 21.05.2019, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, zonja Lefteri Lleshi (Luzi) ka paraqitur një kërkesë me objekt korigjimin e Vendimit nr. 17, datë 10.05.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”*.

2. Në zbatim të pikës 31 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtari i Këshillit relator për ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë të shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019, ka njoftuar Këshillin lidhur me kërkesën e kandidatës Lefteri Lleshi (Luzi) për ndreqjen e gabimeve materiale që rezultojnë në përmbajtjen e dy paragrafëve të vendimit nr. 17, datë 10.05.2019 të këtij Këshilli *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”*, duke përgatitur dhe dërguar për shqyrtim projektvendimin përkatës.

3. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 05.06.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt korigjimin e gabimeve materiale të vendimit nr. 17, datë 10.05.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”*.

4. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur dhe objektin e kërkesës.

5. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) me të drejtë parashtron në kërkesën e saj që nuk është paraqitur për të tërhequr dokumentet e kandidimit dhe nuk ka nënshkruar asnjë dokument pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në këtë rast kemi të bëjmë me gabime materiale në parashtrimin e fakteve objekt procedimi, konkretisht në pikën 8 dhe 23 të vendimi nr. 17, datë 10.05.2019 të këtij Këshilli, e cila duhet të korigjohet bazuar në nenin 112 të kodit të procedurave Administrative.

6. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur, si edhe vendimin nr. 17, datë 10.05.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”* dhe konstatoi se në këtë vendim ka gabime materiale në pjesën përshkruese të fakteve objekt procedimi. Për rrjedhojë, kërkesa e zonjës Lefteri Lleshi (Luzi) është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

7. Kështu, nga shqyrtimi i akteve dhe përmbajtjes së vendimit, rezulton se, në pikën 8 dhe në fjalinë e fundit të pikës 23 të vendimit nr. 17 datë 10.05.2019 parashtrohet se:

“ Në datën 08.04.2019, kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, kopje e së cilës gjendet në dosjen e kandidimit. ”.

“23..... Kandidatja është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, është paraqitur në datë 08.04.2019.”.

8. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se, sikurse me të drejtë parashtron në kërkesën e saj, kandidatja Lefteri Lleshi (Luzi) nuk është paraqitur për të tërhequr dokumentet e kandidimit dhe se nuk ka nënshkruar asnjë dokument pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

9. Për rrjedhojë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se Vendimi nr. 17, datë 10.05.2019 ka gabime materiale në parashtrimin e fakteve objekt procedimi, konkretisht në pikën 8 dhe 23.

10. Prandaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerëson se në këtë rast jemi përpara gabimeve materiale dhe pasaktësive të dukshme të tekstit arsyetues të aktit administrativ dhe se, si të tilla, ato duhet të korrigjohen në çdo kohë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 dhe 3 të nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative, si edhe të pikës 44 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Korrigjimin e vendimit nr. 17, datë 10.05.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”*, duke hequr nga teksti i tij pikën 8 dhe fjalinë e fundit të pikës 23.

2. Ky vendim bashkohet dhe konsiderohet pjesë integrale e Vendimit nr. nr. 17, datë 10.05.2019 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *“Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së zonjës Lefteri Lleshi (Luzi), për shkak të tërheqjes nga kandidimi për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”*.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI